



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:228607  
Datë: 27.02.2024  
Numri i dokumentit: 05378536

C.nr.771/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Kosovare Musliu Prokshaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.K.S. (BKS), me seli në Prishtinë, Rruga “Lidhja e Pejës”, Magjistratja Prishtinë – Fushë Kosovë, pa numër, përfaqësuar sipas autorizimit nga D.C.A. me zyrtar L.E., kundër të paditurit S.R., Rr. “U.” nr., Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Q.R. nga Skenderaj Rr. “...”, me objekt kontesti rimbursim i dëmit, vlera e kontestit 161.00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 08.02.2024, në prezencë të përfaqësueseve të palëve ndërgjygjese, me datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses B.K.S., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri, S.R. nga Prishtina, që në emër të rimbursimit të dëmit për aksidentin e datës 20.05.2013, paditëses t’ia paguajë shumën prej 161.00€, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga data pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET paditësja B.K.S. me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguajë të paditurit S.R., nga Prishtina, shumën në lartësi prej 182.00€, në afati prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja B.K.S. (BKS), me seli në Prishtinë, me datë 28.03.2017, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit S.R., për rimbursimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 20.05.2013.

Paditësja në padi dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me datë 20.05.2013, rreth orës 17:00, në Prishtinë, i padituri me automjetin e VW-Kombi, me targa të regjistrimit ....., ka shkaktuar aksident trafik, duke e goditur automjetin e të dëmtuarit D.K. Automjeti i të paditurit – shkaktarit të aksidentit ka qenë

i pa siguruar, respektivisht i kishte skaduar afati i periudhës së sigurimit në momentin e aksidentit, ashtu që paditësja, bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia (LSDA), të dëmtuarit në këtë aksident, D.K., i ka kompensuar dëmin e pësuar në aksident, për çka me datë 14.06.2013 ka lidhur ujdi jashtëgjyqësore, kurse me datë 07.07.2013 ka bërë transferimin e mjeteve tek i dëmtuari. Ka shtuar se kërkesa e palës paditëse nuk është parashkruar, pasi që duke u bazuar 357 të LMD –së paragrafi 2 në të cilën parashihet përshtkrimi në afat prej 5 vitesh andaj konsiderojmë se parashkrimi në këtë qeshje nuk është arritur. Bazuar në nenin 18, paragrafi 1 të LSDA-së ka parashtruar padi në gjykatë, duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe të detyrohet i padituri që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit t’ia paguaj shumën prej 161.00 €, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë si dhe shpenzimet e procedurës.

I padituri në përgjigje në padi dhe ne fjalën përfundimtarë ka theksuar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditëses në këtë çështje juridike pasi që nga provat e bashkangjitura padisë rezulton se kërkesa e palës paditëse është parashkruar në kuptim të nenit 357 të LMD-së, nga se me datë 20.05.2013, ka ndodhur aksidenti, në rastin konkret kemi parashkrim pasi që është arritur ujdia jashtë gjyqësore me dt. 14.06.2013 ndërsa me dt. 07.07.2013 është bërë urdhër transferi ashtu që nga kjo date pala paditëse ka qen në njohuri për personi përgjegjës për shumën arritshme ndërsa padinë në gjykatë e ka parashtruar me datë 28.03.2017 ku vlen të theksohet se kanë kaluar më shumë se tre vite. Mbi bazën e kësaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzoi si të pa bazuar padinë e paditëses dhe ta detyrojë paditësen që të paditurit t’ia kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurale.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 08.02.2024, sipas propozimit të palëve, ka administruar provat relevante dhe atë: Fondi i kompensimit me nr.994/2013 e dt.31.05.2013, transferi i dt.07.07.2013, urdhër-transferi me nr.1132/13 dt.20.06.2013, ujdia jashtë gjyqësore me nr.394/13 dt.14.06.2013, vendimi me nr.FK-994/2013 dt.06.06.2013, aktvendimi i dëmit me nr.994-13 dt.03.06.2013, librezë e automjetit me nr.01-346-AM, paraqitja e dëmit e dt.20.05.2013, vendimi i komisionit të shkalle së par për trajtimin e dëmeve me nr. 994/12 dt.06.06.2013, raporti i aksidentit me nr. 13-AR-1443 dt. 20.05.2013 si dhe skica e vendi të aksidentit, fotodokumentacione të aksidentit, procesverbali mbi dëmit të automjetit me nr. 994/12, polisa e sigurimit për periudhën e vlefshmëri 30.08.2012 deri 30.08.2013, kërkesa për dëmshpërblim me nr. 0000991 dt. 31.05.2013.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 të LPK-së, gjeti se në këtë çështje juridike kontestimore kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara gjykata ka konstatuar se me datën 20.05.2013, rreth orës 17:00, në Prishtinë, i padituri me automjetin e VW-Kombi, me targa të regjistrimit ....., ka shkaktuar aksident trafik, duke e goditur automjetin e të dëmtuarit D.K., i cili në momentin e aksidentit ka qenë i pa siguruar, respektivisht i kishte skaduar afati i periudhës së sigurimit në momentin e aksidentit.

Nga vendimi nr.FK.nr.994/2013 i datës 06.06.2013, gjykata gjeti se i dëmtuari D.K, ka paraqitur kërkesë për kompensim dëmi të paditësja B.K.S. (BKS) me seli në Prishtinë, ku komisioni i shkallës së parë i paditëses me këtë vendimin, ka vlerësuar se ka bazë juridike për kompensimin e të dëmtuarit në këtë rast, duke i ofruar të dëmtuarit shumën prej 161.00€, për aksidentin e shkaktuar nga i padituri S.R.

Me ujdinë jashtëgjyqësore, me nr. 394/13 të datës 14.06.2013, e lidhur mes B.K.S. dhe të dëmtuarit D.K., gjykata konstaton se palët me ujdë rregullojnë të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me rastin e dëmit material dhe jo material, të pësuar në aksidentin e datës 20.05.2013, përgjegjës i të cilit ishte tani i padituri i cili ngiste automjetin VW-Kombi, me targa të regjistrimit .....

Nga urdhër pagesa – transferi bankar i datës 07.07.2013, gjykata ka konstatuar faktin se paditësja ka kryer pagesën për të dëmtuarin D.K., detyrimin sipas ujdisë jashtëgjyqësore të cekur më lartë. Kjo e vërtetuar dhe me urdhër transferin e dhënë nga paditësja me datë 14.06.2013.

Gjykata gjen si të bazuar pretendimin e të paditurit se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet, është përfshirë në parashkrim, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 362 paragrafi 4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve, ku parashihet se *“Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari, ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguruarit ndaj siguresit fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, respektivisht kur i siguruari t’ia ketë shpërblyer dëmin”*.

Gjykata, bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, provat materiale të administruara në këtë procedurë dhe faktet e pohuara nga pala paditëse, gjeti se kërkesa e palës paditëse është parashkruar në kuptim të nenit 357 par.1 *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.”* dhe nenit 362 paragrafi 4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve. Kjo sepse paditësja, lidhur me aksidentin e datës 20.05.2013, kishte dëmshpërblyer të dëmtuarin Daut Krasniqi, në shumë prej 161.00€, duke realizuar pagesën me datë 07.07.2013, ndërsa padinë në gjykatë për rimbrusim të dëmit e ka parashtruar me datë 28.03.2017, pra pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar nga koha e pagesës së dëmit. Gjykata, në interpretim të dispozitës nga paragrafi 4, të nenit 362, të LMD-së, gjen se dispozita në fjalë ka përcaktuar se për rimbrusim të siguresit ndaj debitorit regresues në bazë të sigurimit të auto përgjegjësive kërkesat parashkruhen për tre vite dhe si datë e fillimit të rrjedhës së afatit të parashkrimit është data kur siguresi ka shpërblyer dëmin të dëmtuarit, e që në rastin konkret është data 07.07.2013, e pohuar nga pala paditëse në padi dhe seancë gjyqësore, ashtu që kërkesa e palës paditëse është përfshirë në parashkrim me datë 31.12.2016, ndërsa padija në gjykatë është parashtruar me date 28.03.2017 pasi që kërkesa është parashkruar .

Gjykata, i gjen si të pa bazuara pretendimet e palës paditëse se kërkesa nuk është përfshirë në parashkrim, pasi që duke u bazuar 357 të LMD –së paragrafi 2 në të cilën parashihet përskrimi në afat prej 5 vitesh andaj parashkrimi në këtë qeshje nuk është arritur, nga se në këtë çështje

juridike kemi të bëjmë me kërkesën nga rimbursimi, ashtu që afati i parashkrimit është 3 vjeçare dhe llogaritet nga data kur siguruesi shpërblen demin personit të siguruar.

Gjykata, me rastin e vendosjes, i vlerësoi edhe provat dhe faktet tjera, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 449 dhe 452 par 1 të LPK-së, ku është obliguar pala paditëse që të paditurit, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 182.00€. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes ne padi në shumë prej 78 €, si dhe për një seance gjyqësore në shumë prej 104.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.771/17, datë 27.02.2024

Gjyqtarja

Kosovare Musliu Prokshaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.